



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 08.03.2025

Numër Protokoli: 1897/2025

A.nr.179/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Prenaj, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.179/2025, të datës 23.01.2025, e parashtruar nga ankuesja L.M-S, kundër organit të punësimit: Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë, në çështjen juridike “*transferim i përhershëm*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.03.2025 mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.179/2025, e datës 23.01.2025, e parashtruar nga ankuesja L.M-S

A r s y e t i m

Nëpunësja civile L.M-S (*tutje referuar ankuesja*), më datë 22.01.2025, përmes ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e regjistruar më datë 23.01.2025, me bazë kontesti “*kundër shkeljes së Vendimit me Ref.AZHB-07/4/504/2024 të datës 04.01.2024 për transferim të përhershëm në pozitën profesional*”

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.01.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë, ndërsa, kjo e fundit më

datë 03.02.2025, ka përcjell përgjigje në ankesë, së bashku më shkresat referuar çështjes në procedurë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 480/2025 të datës 23.01.2025, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankueses; Emailin e ankueses nëntor 2024 për M.G dhe I.K; Akt Emërimit me numër protokollit 2613 të datës 23.06.2022; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesen i datës 24.01.2024; Vendimin Ref.AZHB07/4/28/2023 të datës 27.06.2023 për transferim të përkohshëm; Vendimin Ref.AZHB07/4/504/2023 të datës 04.01.2024 për transferim të përhershëm; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 31.01.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 03.02.2025.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankueses, **është e palejueshme, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesja fillimisht sipas Akt Emërimit me numër protokollit 2613 të datës 23.06.2022, është punësuar në pozitën Zyrtar i Lartë për Miratimin e Projekteve në Drejtorinë e Miratimit të Projekteve në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë.

Tutje sipas Vendimit Ref.AZHB-7/4/28/2023, të datës 27.06.2023 të Menaxheres së Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë, është transferuar në mënyrë të përkohshme për periudhën nga data 01.07.2023 deri më datë 31.12.2023 në pozitën Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa, ndërsa sipas Vendimit me Ref.AZHB-07/4/504/2024 të datës 04.01.2024, të zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë është transferuar në mënyrë të përhershme nga pozita Zyrtar i Lartë për Miratimin e Projekteve në pozitën Zyrtar i Lartë për Financa-Zyrtar për Shpenzime.

Ankuesja në nëntor të vitit 2024, përmes emailit zyrtar i është drejtuar z. M.G dhe z. I.K, duke kërkuar që pozita e saj të mbetet sipas vendimit për transferim të përhershëm, sepse përshkrimi i pozitës i dërguar tek komisioni për hartimin e shtojcës për strukturë të draft rregullores së brendshme është krejtësisht i ndryshëm nga pozita që mbaj pra është për pozitën Zyrtare e Lartë Shpenzuese. Ka kërkuar të mbetet në fuqi pozita sipas vendimit për transferim si Zyrtare e Lartë për Buxhet ose në të kundërtën të shfuqizohet vendimi për transferim të përhershëm.

Pas heshtjes lidhur me kërkesën e ankueses, e njëjta ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin që pozita që mbaj ka përshkrim krejt tjetër i cili është dërguar nga ZKF si Zyrtare e Lartë Shpenzuese tek komisioni për hartimin e shtojcës për strukturën të draft rregullores së brendshme është krejtësisht i ndryshëm në raport me pozitën që jam transferuar sipas vendimit për transferim. Andaj e njëjta kërkon që të trajtohen padrejtësitë që janë bërë duke u bazuar në vendimin e transferimit të përhershëm apo të shfuqizohet vendimit dhe

të kthehet në Divizionin për Miratimin e Projekteve sipas akt emërimit si Zyrtar e Lartë për Miratimin e Projekteve.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës konstaton se sipas Vendimit me Ref.AZHB-07/4/504/2024 të datës 04.01.2024, të zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë është transferuar në mënyrë të përhershme nga pozita *Zyrtar I Lartë për Miratimin e Projekteve* në pozitën *Zyrtar I Lartë për Financa-Zyrtar për Shpenzime*, ndërsa nuk argumentohet se e njëjta e ka kontestuar më parë vendimin e cekur lidhur me transferimin e përhershëm të saj në pozitën e transferuar, për rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesja lidhur me pakënaqësitë ndaj vendimit të cekur më lartë është dashur të kontestoj të njëjtin sipas procedurave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publike, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3, ku përcaktohet se: “3. *Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil..*”, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 124 paragrafit 1 dhe nenit 127 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *Neni 124 paragrafi 1, 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim..., Neni 127 paragrafi 1: 1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ...*

Andaj Kolegji i Këshillit, referuar Vendimit me Ref.AZHB-07/4/504/2024 të datës 04.01.2024, konstaton se është fakt i pakontestueshëm se ankuesja është transferuar në mënyrë të përhershme në pozitën *Zyrtar I Lartë për Financa-Zyrtar për Shpenzime*, kështu që duke marr parasysh që Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë, sipas përgjigjes në ankesë të datës 03.02.2025, ka njoftuar se çështja e rregullores për organizmin e brendshëm është në proces dhe pas miratimit është kompetencë e komisionit të ristrukturimit të vendos për procesin, andaj në rrethanat e tilla duke marr parasysh faktin se ende institucioni punëdhënës nuk ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës, atëherë në këtë fazë është objektivisht e pamundur të vërtetohet supozimi se ankueses do i cenohen të drejtat nga marrëdhënia e punës, endja, mbi këtë gjendje të fakteve rrjedhë së ankesa është e palejuar.

Në kontekst të mbrojtjes së të drejtave nga marrëdhënia e punës, si e drejte kushtetuese dhe ligjore, Kolegji thekson faktin se hedhja poshtë e ankesës A.nr.179/2025, nuk nënkupton mohimin e së drejtës së ankueses që e njëjta pas përfundimit të klasifikimit të vendeve të punës dhe procesit të ristrukturimit të inicioj procedurë ankimi në rast se pretendon së nga procesi i ristrukturimit i janë cenuar të drejtat e saj nga marrëdhënia e punës.

Bazuar në konstatimet si më sipër, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, me numër A.nr.179/2025

Klatrina Prenaj

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses L.M-S;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në AZHB; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.